

**VENDIM**  
**Nr.204, datë 20.12.2010**

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “TV  
KABLLOR STAR” SUBJEKTIT “STAR TV” SHPK**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Star Tv” sh.p.k. për televisionin privat kabllor “Tv kabllor Star”, në bashkitë Durrës, Kavajë, Lushnjë dhe Elbasan.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**